

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Më janë marrë shtatë tituj” – Florentino Perez përballlet me Barcelonën në gjykatë
ADRESA	https://albeu.com/sport/me-jane-marre-shtate-tituj-florentino-perez-perballet-me-barcelonen-ne-gjykate/1031280/
BURIMI	albeu.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	28 shtator 2026, 15:45:49 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	28 shtator 2026, 15:41:20 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	206d1c26c5dd60311309007771850368bb857ceedb2173b8f66400be3ac9dd4f
TEKSTI	21a8cb20c0d48dcb487f6029c96a2be677b374adec8bf017aa63165b503d7e45
PAMJA	60f4ac18a1afc69cd4e841b2e801b19d2f7335966d0fb4bdeb8ee513a207cc3c

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	072efd9e2afd48cdd2e19f8e49edec6bde787404bf4a987c1d589b3d66b534cc
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	2a9c3c61cd0a94fc8d628189ad3d77be9fe8dbec0733dde85be2277fcec101e
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/072efd9e2afd48cdd2e19f8e49edec6bde787404bf4a987c1d589b3d66b534cc>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Më janë marrë shtatë tituj – Florentino Perez përballet me Barcelonën në gjykatë



Përplasja e gjatë mes Barcelonës dhe Real Madridit pritet të zhvillohet edhe përpara institucioneve të drejtësisë, pas deklaratave të presidentit madrilen, Florentino Perez, për rastin Negreira.

Perez dhe përfaqësuesit e klubit katalanas janë thirrur në një seancë ndërmjetësimi më 25 nëntor. Takimi është caktuar nga një gjykatë në Madrid si procedurë paraprake përpara nisjes së mundshme të një çështjeje penale.

Barcelona kërkon që presidenti i Real Madridit të tërheqë deklaratat që klubi i konsideron shpifëse dhe dëmtuese për reputacionin e tij. Nëse nuk arrihet një marrëveshje, katalanasit kanë paralajmëruar se do të ndjekin rrugën e një padie penale për shpifje.

Çështja lidhet me fjalët e Perezit gjatë një konference për shtyp të mbajtur më 12 maj, ku ai foli gjatë për rastin Negreira dhe pagesat që Barcelona ka kryer ndër vite ndaj Jose Maria Enrique Negreiras, ish-zëvendëspresidentit të Komitetit Teknik të Gjyqtarëve në Spanjë.

Gjatë asaj konference, Perez pretendoi se pasojat e këtij rasti kanë ndikuar në futbollin spanjoll.

"Kam fituar shtatë Liga Kampionësh dhe shtatë tituj lige, dhe mund të kenë qenë 14, sepse më janë vjedhur shtatë tituj", deklaroi presidenti i Real Madridit.

Ai foli gjithashtu për pozicionin e klubit madrilen ndaj çështjes Negreira dhe për mbështetjen që, sipas tij, ka marrë nga anëtarët e Realit.

"Anëtarët e Realit janë me mua në luftën kundër Negreiras. Nuk është gjithmonë vetëm Madridi që dëmtohet, por edhe klubet e tjera. Barcelona gjithmonë përfiton", u shpreh Perez.

Departamenti ligjor i Barcelonës e shqyrtoi situatën pas deklaratave dhe në qershor nisi procedurën e pajtimit. Synimi i klubit ishte që Perez të hiqte dorë nga pretendimet që katalanasit i vlerësojnë si shpifëse dhe negative

të fundit /



VIDEO/ Nga Tirana te rivali kryeqytetas, Bernard Berisha vizit...



Zjarr i përmasave të mëdha në kodrën pranë Mëmlishtit, flakët...



Më janë marrë shtatë tituj – Florentino Perez përballet me...



Përplasja dhe akuza për racizëm pas fitores së Irlandës ndaj Izraelit



Rihanna ndan pamje plot humor nga familja: Rocky me paruke dh...



Enver Hoxhaj merr drejtimin e Komisionit Parlamentar për Arsim



LSDM: Dështimi i reformave nga qeveria po e mban Maqedoni...



ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

për imazhin e tyre.

Nëse ai nuk tërhiqet, Barcelona pritet të ndërmarrë hapin e radhës dhe të kërkojë hapjen e një procesi penal.

Në të njëjtën periudhë, Perez e cilësoi rastin Negreira si "skandalin më të madh të korrupsionit në historinë e futbollit". Ai njoftoi gjithashtu se Real Madridi po përgatiste një dosje të gjerë për t'ia dorëzuar UEFA-s.

Në qershor, Real Madridi i kërkoj UEFA-s të rikthente procedurat disiplinore ndaj Barcelonës, duke argumentuar se kishte prova të reja për pagesat ndaj Negreiras. Barcelona i ka kundërshtuar këto pretendime dhe ka deklaruar se fjalët e Perezit kanë tejkaluar kufijtë e kritikës së pranueshme.

Seanca e ndërmjetësimit do të zhvillohet më 25 nëntor dhe synon të zgjidhë konfliktin përpara se ai të kalojë në një fazë të mundshme penale.

Shtuar më 28.09.2026 17:41

Tags: BARCELONA , Florentino Perez , Joan Laporta , la liga , real madrid



VIDEO/ Nga Tirana te rivali kryeqytetas, Bernard Berisha viziton ish-klubin...



Përplasje dhe akuza për racizëm pas fitores së Irlandës ndaj Izraelit



E ardhmja e Haaland në La Liga varet nga vendimi për Manchester Cityn



Debat i ashpër pas Izrael-Irlandë: "Duhet të të vijë turp për atë që po ndodh ...



Kosova përballlet sërish me Izraelin pas afro tre vjetësh, me katër pikë nga dy...



Real Madridi vëzhgon nga afër të ardhmen e Alexis Mac Allister te Liverpooli



Ish-futbollisti i Barcelonës rrëfen zemërimin e Guardiols pas publikimit...



Matoshi kërkon reagim të menjëhershëm nga Kosova: Izraeli duhet...



© 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko...

Kërko

Kryesore

Erion Veliaj
Free Esim
Zgjedhjet 2025
Belinda Balluku
SPAK
Kombëtarja

Kategori

Lifestyle
Showbiz
Tech
Shëndetësi
Argetim
Enciklopedi

Linqet

Live tv shqiptare
Moti në Shqipëri
Travel
Horoskopi
Livescore
News from Albania

Tags

Edi Rama
Albania News
Ilir Meta
Piranjat
gazeta, tv, portale
Sali Berisha

Moti

Moti në Tiranë
Moti në Prishtinë
Moti në Shkup
Moti në Durrës
Moti në Prizren
Moti në Tetovë

© 2003 - Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kontaktimi | Kushtet e Përdorimit | Privacy Policy | Powered by: orihost.com